

## Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**Objekti i procedurës:** “Blerje kënde lodrash dhe palestrimi për ambiente të jashtme”.

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):** 37535200-9, 37535210-2, 37535240-1, 37442900-8

**Vlera e fondit limit:** 13 128 964 (trembëdhjetëmilion e njëqindnjëzetetetëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetekatër) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

*2.1.1 Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. Ky kriter synon të sigurojë që çdo operator ekonomik të konfirmojë paraprakisht, nën përgjegjësi ligjore, përmbushjen e kushteve dhe kërkesave të përgjithshme të parashikuara nga legjislati në fuqi për prokurimin publik. Përmes vetëdeklarimit mundësohet një zhvillim më efikas i procedurës së vlerësimit të ofertave, duke shmangur ngarkesën administrative të paraqitjes së menjëhershme të dokumentacionit të plotë nga të gjithë ofertuesit, ndërkohë që autoriteti kontraktor ruan të drejtën për të kërkuar dhe verifikuar

dokumentacionin provues përkatës në fazat e mëvonshme të procedurës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

*2.1.1 OE duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa vlera e fondit limit që prokurohet.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/b dhe nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar sa vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/b ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar...”*.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

## **2.3. Kapaciteti teknik:**

*2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën sa 35 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të*

*mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën” nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 35 % të vlerës së fondit limit.

Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është mbi kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur.

Përçindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

*2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi, ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori për tregëtimin e mallrave objekt prokurimi, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në rastin e autorizimit të distributorit duhet paraqitur dhe marrëveshja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Secili nga dokumentat e paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite në rast verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Ky kriter është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar cilësinë, origjinën dhe sigurinë e produkteve që do të furnizohen në kuadër të këtij prokurimi, i cili ka si objekt blerjen e këndeve të lodrave dhe pajisjeve të palestrimit për ambiente të jashtme.

Duke qënë se këto produkte janë të destinuara për përdorim nga fëmijë dhe komuniteti në ambiente publike, ato duhet të përmbushin standarde të larta sigurie dhe cilësie, si dhe të jenë të prodhuara sipas normave ndërkombëtare përkatëse. Në këtë kuadër, kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose nga një distributor i autorizuar synon të sigurojë që operatori ekonomik ofertues të ketë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë ose të ndërmjetësuar, por të ligjshme dhe të verifikueshme, me burimin e mallrave, duke shmangur kështu furnizimin me produkte të pasigurta, të paidentifikuara apo jashtë standardeve të kërkuara.

Ky kriter shërben gjithashtu për të garantuar gjurmueshmërinë e produkteve, duke mundësuar identifikimin e qartë të prodhuesit dhe verifikimin e të dhënave të tij nga autoriteti kontraktor në çdo fazë të procedurës, përfshirë edhe pas lidhjes së kontratës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për produkte të tilla, të cilat janë të ekspozuara ndaj kushteve atmosferike dhe përdorimit intensiv,

dhe për të cilat është e nevojshme të sigurohet jo vetëm cilësia fillestare, por edhe mbështetja teknike, garancia dhe furnizimi me pjesë këmbimi në vijimësi.

Kërkesa për paraqitjen e marrëveshjes midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit, në rastet kur autorizimi jepet nga distributori, ka për qëllim të shmangë zinxhirët e paqartë të furnizimit dhe të sigurojë që autorizimi i paraqitur është real, i vlefshëm dhe i mbështetur në një marrëdhënie kontraktuale të dokumentuar. Kjo rrit besueshmërinë e ofertës dhe minimizon rrezikun e paraqitjes së autorizimeve fiktive apo të pavlefshme.

Njëkohësisht, kërkesa që dokumentacioni i paraqitur të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, si numri i telefonit, fax-i, adresa e postës elektronike dhe faqja zyrtare në internet, është e lidhur drejtpërdrejt me nevojën për verifikim nga ana e autoritetit kontraktor. Kjo i jep mundësi këtij të fundit të konfirmojë autenticitetin e dokumenteve, ekzistencën reale të prodhuesit dhe vlefshmërinë e autorizimit, duke rritur transparencën dhe integritetin e procedurës së prokurimit. Në aspektin teknik dhe funksional, për shkak të natyrës së produkteve që do të prokurohen, të cilat përfshijnë struktura metalike, elementë plastikë të përpunuar dhe komponentë mekanikë që duhet të jenë të qëndrueshëm ndaj kushteve të jashtme dhe të sigurt për përdoruesit, është e domosdoshme që furnizimi të realizohet nga operatorë ekonomikë që kanë akses të garantuar dhe të autorizuar tek prodhuesit, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara.

*2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë ose fragmente(faqe) të katalogut/ëve të lëshuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, duke pasqyruar qartë të gjitha të dhënat teknike të kërkuara, skicat e paisjeve dhe lodrave, plan vendosjet e tyre, gjithashtu të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet përkatëse të kërkuara, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat në DT, si dhe të plotësohen të dhënat sipas tabelës së mëposhtme.*

*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. .... 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u

*kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”*. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik.

Kriteri i kualifikimit që kërkon paraqitjen e katalogëve, broshurave ose fragmenteve të katalogut të lëshuara nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, përbën një element thelbësor teknik për vlerësimin e ofertave dhe garantimin e përputhshmërisë së produkteve të ofruara me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me blerjen e këndeve të lodrave dhe pajisjeve të palestrimit për ambiente të jashtme, të cilat kanë karakteristika të ndërlikuara teknike, strukturore dhe funksionale, është e domosdoshme që autoriteti kontraktor të disponojë dokumentacion të detajuar dhe të verifikueshëm mbi specifikimet reale të produkteve të ofruara.

Paraqitja e katalogëve ose broshurave zyrtare të prodhuesit siguron një burim autentik informacioni teknik, i cili nuk është subjekt interpretimi nga operatori ekonomik, por pasqyron drejtpërdrejt karakteristikat, përmasat, materialet përbërëse, standartet e prodhimit dhe performancën e produkteve. Kjo i mundëson autoritetit kontraktor të kryejë një vlerësim objektiv dhe të bazuar në të dhëna konkrete, duke shmangur situatat kur ofertuesit paraqesin përshkrime të përgjithshme apo deklarative që nuk provojnë realisht përmbushjen e specifikimeve teknike.

Kërkesa që në katalogë të pasqyrohen qartë të gjitha të dhënat teknike të kërkuara, përfshirë skicat e pajisjeve dhe lodrave si dhe planvendosjet e tyre, lidhet drejtpërdrejt me natyrën e produkteve që do të instalohen në terren. Këto elemente janë të nevojshme për të verifikuar jo vetëm përmasat dhe përbërjen e secilit produkt, por edhe përshtatshmërinë e tyre me hapësirat e parashikuara dhe standartet e sigurisë në përdorim. Në veçanti, planvendosjet ndihmojnë në vlerësimin e organizimit funksional të këndeve të lojërave dhe pajisjeve të palestrimit, duke garantuar që ato të instalohen në mënyrë të sigurt dhe efektive për përdoruesit.

Detyrimi për të markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet përkatëse në katalog ka për qëllim të lehtësojë procesin e verifikimit nga ana e autoritetit kontraktor, duke shmangur paqartësitë dhe interpretimet e gabuara. Në këtë mënyrë sigurohet që çdo karakteristikë teknike e kërkuar të jetë e identifikueshme dhe e krahasueshme drejtpërdrejt me informacionin e dhënë nga prodhuesi, duke rritur saktësinë dhe transparencën e vlerësimit teknik të ofertave.

Njëkohësisht, kërkesa që fragmentet e katalogut të tregojnë qartë se janë pjesë e një katalogu dhe të identifikojnë prodhuesin përkatës është e lidhur me nevojën për të garantuar autenticitetin dhe besueshmërinë e dokumentacionit të paraqitur. Kjo shmang paraqitjen e materialeve të shkëputura, të manipuluar apo të paidentifikueshme, dhe i jep mundësi autoritetit kontraktor të verifikojë burimin e informacionit dhe përputhshmërinë e tij me produktet reale që ofrohen.

Në aspektin teknik dhe funksional, për shkak të natyrës së produkteve që përfshijnë struktura të përbëra nga elementë metalikë, plastikë dhe mekanikë, të ekspozuara ndaj kushteve atmosferike dhe përdorimit intensiv, është e domosdoshme që çdo element i ofertës të jetë i dokumentuar në mënyrë të detajuar dhe të verifikueshme. Vetëm nëpërmjet katalogëve dhe dokumentacionit teknik

të prodhuesit mund të garantohet që produktet e ofruara përmbushin standardet e kërkuara të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit.

*2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë përputhshmërinë e produkteve të ofertuara me standardet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi. Në përmbushje të kësaj pike duhet të paraqiten certifikatat/deklaratat e konformitetit ose të performancës të lëshuara nga prodhuesi ose nga institucione të pavaruara të akredituara të cilat vërtetojnë përputhshmërinë e modeleve të produkteve me standardet/normat/referencat e kërkuara në shtojcën e specifikimeve teknike.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në pikën 1 të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 79 pika 1 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*

Në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Ky kriter kualifikimi përbën një element thelbësor teknik për garantimin e sigurisë, cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mallrave që do të furnizohen në kuadër të këtij prokurimi. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me furnizimin dhe instalimin e këndeve të lodrave dhe pajisjeve të palestrimit për ambiente të jashtme, të cilat përdoren drejtpërdrejt nga fëmijë dhe komuniteti, përmbushja e standardeve teknike dhe e normave të sigurisë është një kërkesë e domosdoshme dhe jo e negociueshme.

Paraqitja e certifikatave apo deklaratave të konformitetit të lëshuara nga prodhuesi ose nga institucione të pavarura të akredituara siguron që produktet e ofruara janë testuar dhe verifikuar në përputhje me standarde të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto dokumente përbëjnë prova të drejtpërdrejta dhe të besueshme se produktet plotësojnë kërkesat për siguri mekanike, qëndrueshmëri strukturore, rezistencë ndaj kushteve atmosferike, si dhe përdorim të sigurt për grupmoshat përkatëse. Në mungesë të këtij dokumentacioni, autoriteti kontraktor nuk ka mundësi të sigurojë në mënyrë objektive që produktet e propozuara përmbushin kriteret minimale të kërkuara, duke rritur ndjeshëm rrezikun për përdoruesit finalë.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt edhe me nevojën për të garantuar që produktet janë prodhuar sipas proceseve të kontrolluara dhe të certifikuara, si dhe që ato i janë nënshtruar testeve përkatëse nga organe kompetente. Përfshirja e mundësisë për të paraqitur dokumentacion të lëshuar nga institucione të pavarura të akredituara rrit më tej nivelin e besueshmërisë dhe objektivitetit, pasi

këto institucione operojnë sipas standardeve të akreditimit dhe ofrojnë garanci të paanshme mbi cilësinë dhe performancën e produkteve.

Në aspektin teknik, për produktet që do të vendosen në ambiente të jashtme, është veçanërisht e rëndësishme që të vërtetohet rezistenca ndaj faktorëve mjedisorë si rrezatimi ultraviolet, lagështia, temperaturat ekstreme dhe konsumimi nga përdorimi i vazhdueshëm. Certifikatat dhe deklaratat e konformitetit japin informacion të strukturuar mbi këto karakteristika dhe mbi testimet e kryera, duke mundësuar një vlerësim të saktë të jetëgjatësisë dhe performancës së produkteve në kushte reale përdorimi.

Njëkohësisht, kërkesa që këto dokumente të vërtetojnë përputhshmërinë e modeleve konkrete të produkteve me standardet dhe referencat e kërkuara në specifikimet teknike siguron që vlerësimi të mos mbështetet në deklaratime të përgjithshme, por në evidenca specifike për produktet e ofruara. Kjo shmang situatat kur operatorët ekonomikë paraqesin certifikime të përgjithshme të kompanisë apo produkteve të tjera, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me artikujt e ofruar në këtë procedurë.

Për sa më sipër, ky kriter kualifikimi është i domosdoshëm për të garantuar një proces prokurimi të sigurt dhe të përgjegjshëm, në përputhje me rëndësinë dhe ndjeshmërinë e objektit të kontratës..

*2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertë teknike, në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga ofertuesi për produktet objekt prokurimi. Në plotësim të kësaj kerkese oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si mëposhtë:*

*Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës të paraqitur nga AK.*

<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i produkteve</i>	<i>Emërtimi kompanisë prodhuese, adresa, web-i</i>	<i>Emertimi i katalogut</i>	<i>Kodi i produktit ose nr. faqes në katalog.</i>
-----------	------------------------------	--	-----------------------------	---

*Emri, adresa dhe website i kompanisë prodhuese, me produktet e të cilëve operatori ekonomik do të paraqitet në ofertim, emërtimi i katalogut të prodhuesit, referenca në katalog, kodi i produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr. i faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes në katalogun përkatës ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”. Në këtë kontekst është kërkuar dhe oferta teknike në formë deklarative, me anë të së cilës do të bëhet i mundur verifikimi më i saktë i artikujve të ofertuar, origjina, konformiteti me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi. Duke marrë

shkas nga kompleksiteti i artikujve objekt prokurimi, gjykohet e nevojshme që gjatë fazës së vlerësimit komisioni i vlerësimit të ofertave të njihet me ofertën teknike, për të bërë të mundur një vlerësim sa më eficient dhe sa më të mirëorientuar.

Ky kriter kualifikimi përbën një element thelbësor për garantimin e një procesi vlerësimi të saktë, të krahasueshëm dhe transparent të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë. Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin furnizimin me kënde lodrash dhe pajisje palestrimi për ambiente të jashtme, të cilat përbëhen nga një shumëllojshmëri komponentësh me karakteristika të ndryshme teknike, është e domosdoshme që informacioni mbi këto produkte të paraqitet në mënyrë të unifikuar dhe të standardizuar.

Paraqitja e ofertës teknike në formën e një table të detajuar i mundëson autoritetit kontraktor të identifikojë qartë dhe pa paqartësi çdo produkt të ofruar, duke e lidhur atë drejtpërdrejt me prodhuesin përkatës, katalogun referues dhe kodin ose faqen konkrete ku gjenden specifikimet teknike. Ky organizim i informacionit shmang interpretimet subjektive dhe mundëson një verifikim të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë të përputhshmërisë së produkteve me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesa që emërtimi i produkteve të bëhet sipas listës së paraqitur nga autoriteti kontraktor siguron një bazë të përbashkët referimi për të gjithë operatorët ekonomikë dhe eliminon rrezikun e konfuzionit apo keqinterpretimit të artikujve të kërkuar. Njëkohësisht, paraqitja e të dhënave të plota të kompanisë prodhuese, përfshirë emrin, adresën dhe faqen zyrtare në internet, garanton transparencë dhe mundëson verifikimin e burimit të produkteve dhe autenticitetit të tyre.

Përfshirja e emërimit të katalogut të prodhuesit dhe referencës së saktë në të, përmes kodit të produktit ose numrit të faqes, është një element teknik i domosdoshëm që siguron gjurmueshmërinë e informacionit dhe lidhjen e drejtpërdrejtë midis produktit të ofertuar dhe dokumentacionit teknik mbështetës. Në këtë mënyrë, autoriteti kontraktor ka mundësinë të verifikojë në mënyrë të pavarur dhe objektive specifikimet teknike të çdo produkti, duke i krahasuar ato me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kjo kërkesë është veçanërisht e rëndësishme për shkak të natyrës teknike dhe funksionale të produkteve që do të furnizohen, të cilat duhet të përmbushin standarde të caktuara sigurie, cilësie dhe qëndrueshmërie në kushte të përdorimit të jashtëm. Në mungesë të një strukture të tillë të detajuar të ofertës teknike, procesi i vlerësimit do të bëhej i vështirë, jo i unifikuar dhe potencialisht subjektiv, duke rritur rrezikun e pranimit të ofertave që nuk përmbushin realisht kërkesat teknike. Në përfundim, ky kriter kualifikimi është në përpjesëtim të drejtë me kompleksitetin dhe rëndësinë e objektit të prokurimit, nuk kufizon konkurrencën në mënyrë të pajustificuar, por përkundrazi garanton një proces të rregullt, transparent dhe të bazuar në evidenca konkrete teknike, duke siguruar që ofertat e paraqitura të jenë të verifikueshme dhe plotësisht të krahasueshme ndërmjet tyre.

*2.3.6 Operatori ekonomik në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor, duhet të paraqesë nga 1 mostër për zerat objekt prokurimi si me poshte:*

<i>Nr</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Lojë e kompozuar me rreshkitëse dhe lisharëse</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
<i>2</i>	<i>Rrotulluese me timon</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
<i>3</i>	<i>Peshore për 2 fëmijë</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
<i>4</i>	<i>Lëkundës me sustë tipi 1</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
<i>5</i>	<i>Pasisje palestrimi FTN 2509</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>

6	<i>Paisje palestrimi FTN 2502</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
7	<i>Tapet gome</i>	<i>m<sup>2</sup></i>	<i>1</i>

*Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”.

Ky kriter kualifikimi ka për qëllim të sigurojë që operatori ekonomik të ofrojë produkte të verifikueshme dhe të krahasueshme në terren, duke mundur një vlerësim të saktë të përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Kërkesa për dorëzimin e mostrave fizike në ditën dhe orën e hapjes së ofertave është një procedurë standarde që synon të eliminojë çdo pasiguri në lidhje me cilësinë, dimensionet dhe funksionalitetin e pajisjeve që do të furnizohen, duke lehtësuar një kontroll të drejtpërdrejtë dhe objektiv.

Sa i përket secilës mostër të kërkuar, argumentimi teknik është si vijon:

Loja e kompozuar me rrëshkitëse dhe lisharëse, një copë, duhet të dorëzohet për të verifikuar dizajnin e integruar të elementëve lojërorë, qëndrueshmërinë strukturore dhe sigurinë për përdorim nga fëmijët. Mostra duhet të përputhet me materialet, dimensionet dhe përmasat që janë përcaktuar në specifikimet teknike dhe të demonstrojë funksionimin e sigurt të rrëshkitëses dhe lisharëses, duke u fokusuar në stabilitetin dhe lidhjen e elementëve.

Rrotulluese me timon, një copë, shërben për të kontrolluar funksionimin mekanik të komponentëve të lëvizshëm dhe ergonominë për përdoruesin. Mostra e dorëzuar duhet të demonstrojë qarkullimin e sigurt dhe të lehtë të timonit dhe të garantojë që lëvizja të jetë e kontrollueshme dhe pa rrezik për fëmijët.

Peshore për dy fëmijë, një copë, duhet të prezantojë sigurinë dhe qëndrueshmërinë e materialeve të përdorura, si dhe saktësinë e matjes. Mostra e dorëzuar mundëson vlerësimin e dimensioneve dhe funksionit të saj, duke garantuar që të përmbushë kërkesat për përdorim të përbashkët nga dy fëmijë njëkohësisht pa rrezik.

Lëkundës me sustë tipi 1 është i nevojshëm për të vlerësuar mekanizmat e sustave, elasticitetin, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e elementëve që lejojnë lëkundjen e kontrolluar. Mostrat do të testohen për rezistencë ndaj ngarkesës, stabilitet në përdorim dhe përputhshmëri me dimensionet e specifikuar.

Paisje palestrimi FTN 2509 dhe FTN 2502, secila një copë, dorëzohen për të verifikuar cilësinë e materialeve, përputhshmërinë me dimensionet dhe dizajnin e përcaktuar në dokumentet teknike, si dhe funksionalitetin dhe sigurinë për aktivitetet fizike në ambiente të jashtme. Mostrat duhet të demonstrojnë që materialet janë rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe përdorimit të vazhdueshëm.

Tapeti gome, një metër katror, është i domosdoshëm për të kontrolluar trashësinë, densitetin dhe qëndrueshmërinë e materialit, përveç aftësisë për drenazh uji dhe rezistencës ndaj ndikimeve atmosferike. Mostra duhet të demonstrojë që përbërja e gomes dhe metoda e prodhimit përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike, duke siguruar siguri dhe stabilitet për përdoruesit.

Për secilën prej mostrave, kërkesa për pranimin e ekuivalentëve pranohen vetëm në rast se ato plotësojnë të njëjtat standarde dhe parametra teknike si artikulli i kërkuar. Kjo siguron fleksibilitet në furnizim pa cenuar përputhshmërinë me kërkesat e sigurisë, funksionalitetit dhe cilësisë. Paraqitja e mostrave fizike për secilin produkt lejon autoritetin kontraktor të kryejë një verifikim të drejtpërdrejtë dhe objektiv të ofertës, duke siguruar që produktet përfundimtare të përmbushin standardet e kërkuara për përdorim në ambientet e jashtme të fëmijëve.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Seti i lodrave për fëmijë për ambient të jashtëm është projektuar për të krijuar një hapësirë të sigurt, funksionale dhe stimuluese për fëmijët. Kombinimi i lodrave të ndryshme dhe mbulesa me tapet bari artificial jo vetëm që ofron mundësi të shumta për lojë, por gjithashtu siguron një sipërfaqe të sigurt për rëniet e mundshme, duke reduktuar ndjeshëm rrezikun e lëndimeve.

Tapeti i barit ka trashësi 4,5 cm, densitet të lartë dhe përshkueshmëri uji minimale 40 litra/min, duke lejuar kullimin e ujit dhe ruajtjen e sipërfaqes të thatë dhe të qëndrueshme. Ai ofron amortizim të goditjeve dhe mbulon sipërfaqen e nevojshme për të gjithë elementët e vendosur në hapësirën e lojës.

Loja e kompozuar me rrëshqitëse dhe lisharëse është dimensionuar me sipërfaqe 17,85 m<sup>2</sup> dhe lartësi maksimale 4,15 m, duke siguruar një hapësirë të mjaftueshme për lëvizje të lirë dhe lojë të koordinuar për shumë fëmijë njëkohësisht. Materiali i përdorur për pjesët plastike është LLDPE (Linear Low-Density Polyethylene), i cili është rezistent ndaj ndikimeve atmosferike, rrezeve UV dhe ndryshkut, duke ruajtur ngjyrën dhe strukturën për të paktën dy vjet. Këndi maksimal i pjerrësisë së rrëshqitëses është 40°, që ofron një lëvizje të kontrolluar dhe të sigurt, duke minimizuar rrezikun e rrëshkitjes së shpejtë ose përplasjes. Çatia dhe tubat me diametër 114 mm dhe trashësi 2,5 mm ofrojnë stabilitet strukturor maksimal, ndërsa lisharëset me sedile për dy fëmijë dhe mbrojtjet metalike galvanizuar nën pllakat plastike parandalojnë ndryshkjen dhe rritin sigurinë gjatë lojës. Zinxhirët e galvanizuar me zhytje të nxehtë sigurojnë lëvizje të butë të lisharëses dhe parandalojnë bllokimin e gishtave. Ngjyrat dhe materialet e përdorura janë në përputhje me rregulloret ushqimore, duke garantuar që fëmijët të mos ekspozohen ndaj substancave të dëmshme. Kjo lodër prodhohet sipas standardeve ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018 dhe EN 1176, duke garantuar siguri, cilësi dhe përputhshmëri me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Rrotulluese me timon ka një diametër minimal 139 cm dhe lartësi 77 cm, duke siguruar qëndrueshmëri dhe stabilitet për përdoruesit. Boshti metalik me gushinetë konike redukton fërkimin dhe konsumimin, duke ofruar lëvizje të qetë dhe të kontrolluar. Sediljet dhe timoni prej HDPE me diametër minimal 29 cm dhe trashësi 18 mm janë rezistente ndaj deformimeve dhe përdorimit intensiv, ndërsa materialet LLDPE që përdoren për pjesët plastike sigurojnë siguri për fëmijët dhe janë të përshtatshme për kontakt me ushqim. Lartësia dhe diametri i pjesës rrotulluese janë përcaktuar për të shmangur rrezikun e përplasjes ndërmjet fëmijëve dhe për të lejuar përdorim të rehatsishëm për grupmosha të ndryshme.

Peshorja për dy fëmijë është e ndërtuar me tuba me diametër minimal 114 mm dhe trashësi muri 2,5 mm, që sigurojnë stabilitet dhe rezistencë ndaj përdorimit intensiv. Sediljet prej polietileni kanë përmasa 49x26x31 cm, duke ofruar rehati dhe siguri gjatë lojës. Pjesët e hapura të tubave janë të mbyllura për të parandaluar korrozionin e shkaktuar nga uji dhe lagështia. Ngjyrat dhe materialet janë të sigurta për fëmijët dhe përputhen me rregulloret ushqimore. Standardet ISO dhe EN garantojnë përputhshmëri dhe siguri maksimale.

Lëkundëset me susta janë të ndërtuara nga figura polietileni i vetëngjyrosur me peshë minimale 8 kg dhe përmasa të përshtatshme për stabilitet. Sustat e çelikut për lekundje kanë tela helikoidale Ø22 mm që mund të shtrihen deri në 25 cm, duke lejuar lëvizje të kontrolluar dhe të sigurt. Montimi në beton me bullona metalike ofron stabilitet maksimal dhe parandalon lëvizje të pakontrolluara. Ngjyrat dhe materialet përdoren në përputhje me rregulloret për shëndetin e fëmijëve dhe standardet ISO dhe EN.

Tapeti bari artificial ka trashësi 4,5 cm dhe densitet 24,675 fibra/m<sup>2</sup>, me peshë totale 2,280 g/m<sup>2</sup>, duke siguruar amortizim të goditjeve dhe një sipërfaqe të qëndrueshme për të gjithë elementët e lodrave. Pjesa e poshtme prej polietileni parandalon degradimin nga kushtet atmosferike dhe ekspozimin ndaj rrezeve UV, duke rritur jetëgjatësinë e produktit. Përshkueshmëria e ujit dhe kullimi i tij sigurojnë që sipërfaqja të mbetet e thatë dhe e sigurt për përdoruesit.

Pajisjet e palestrimit për ambient të jashtëm janë ndërtuar nga çelik dhe polietileni të cilësisë së lartë, duke ofruar rezistencë ndaj kushteve atmosferike dhe përdorim të gjatë. Trupi kryesor i çdo pajisjeje ka tub çeliku me diametër minimal 140 mm dhe trashësi 3 mm, që garanton stabilitet dhe rezistencë ndaj deformimeve. Pjesët lëvizëse kanë diametra dhe trashësi të përcaktuar për lëvizje të qeta dhe të qëndrueshme, ndërsa kushinetat sigurojnë funksionim të saktë dhe të qëndrueshëm. Mbajtësit dhe sediljet e injektuara prej polietileni janë ergonomike dhe të sigurta për përdoruesit. Zona e sigurisë e secilës pajisjeje është të paktën 1500 mm, duke reduktuar rrezikun e përplasjeve dhe aksidenteve. Tapeti modular prej gome me përmasa 40x40x2 cm siguron sipërfaqe jo rrëshkitëse, rezistente ndaj ngricave, kullueshëm dhe 100% të riciklueshëm. Ai është prodhuar me trajtim termik dhe presion të kontrolluar, duke siguruar qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj konsumimit.

Materialet, dimensionet, metodat e prodhimit dhe përputhshmëria me standardet ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018 dhe EN 1176/EN 16630 garantojnë që të gjitha lodrat dhe pajisjet e palestrimit të jenë të sigurta, të qëndrueshme, ergonomike dhe të përshtatshme për përdorim intensiv në ambient të jashtëm. Ky set siguron një eksperiencë të pasur, të sigurt dhe të këndshme për fëmijët dhe përdoruesit e pajisjeve palestrimi, duke përmbushur kërkesat më të larta të cilësisë dhe sigurisë.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**